



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 534/3 Prot.

Tiranë, më 10.07.2020

VENDIM

Nr.53, datë 10.07.2020

PËR

**PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VERIFIKIMIT
TË ZBATIMIT TË VENDIMIT TË KOMISIONERIT NR. 116, DATË 05.11.2019,
NË INSTITUCIONIN BASHKIA KONISPOL**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorit të Përgjithshëm të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes dhe Drejtorit për Çështjet Juridike dhe Marrëdhëniet me Jashtë, në lidhje me verifikimin e zbatimit të Vendimit të Komisionerit Nr. 116, datë 05.11.2019, të Komisionerit, “Mbi përfundimin e verifikimit të kryer në institucionin e qeverisjes vendore Bashkia Konispol, të filluar me urdhrin nr. 65, datë 12.9.2019, të Komisionerit, në lidhje me evidentimin e rasteve të emërimeve në kundërshtim me ligjin në pozicione pune që janë pjesë e shërbimit civil, si dhe zbatimin e standardeve ligjore në strukturimin e shërbimit civil, në përputhje me parimet e ligjit për nëpunësin civil, në këtë bashki”,

KONSTATOVA SE:

Komisioneri, me urdhrin nr. 65, datë 12.9.2019, “Për fillimin e procesit të inspektimit në lidhje me rastet e emërimeve në kundërshtim me ligjin në pozicione pune që janë pjesë e shërbimit civil në njësitë e vetëqeverisjes vendore, si dhe verifikimi i zbatimit të standardeve ligjore në strukturimin e shërbimit civil, si pjesë e rëndësishme e strukturës organizative të institucionit në përputhje me parimet e ligjit për nëpunësin civil”, ka nisur kryesisht procesin e verifikimit në të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore, ku u përfshi dhe Bashkia Konispol.

Pas përfundimit të mbikëqyrjes, Komisioneri ka dërguar pranë Bashkisë Konispol, vendimin paralajmërues për rregullimin e ligjshmërisë me nr. 116, datë 05.11.2019, duke i lënë institucionit detyra për përmirësimin e situatës, si dhe një afat prej 3 (tre) muajsh për zbatimin e tyre.

Me kalimin e afatit të lënë në Vendimin e mësipërm, Bashkia Konispol, ka informuar Komisionerin me shkresën nr. 569/1prot., datë 24.06.2020, protokolluar te Komisioneri me nr. 534/1 prot., datë 29.06.2020, në lidhje me veprimet administrative të ndërmarra në zbatim të detyrave të lëna në dispozitivin e vendimit paralajmërues, duke bashkëngjitur edhe dokumentacionin që provon zbatimin e tij.

Duke analizuar materialin shkresor të dërguar nga institucioni, arrij në përfundimin se, nga ana e institucionit të mbikëqyrur, Bashkia Konispol, janë zbatuar plotësisht detyrat e lëna në vendim.

Konkretisht:

1. Institucioni ka marrë masa dhe ka rikthyer gjendjen e ligjshmërisë për 3 punonjësit që janë pjesë e shërbimit civil (***** , në pozicionin e punës “*Specialist Finance dhe Buxheti*”, ***** , në pozicionin e punës, “*Specilaist i Artit, Kulturës dhe Sportit*” dhe ***** në pozicionin e punës “*Inspektor Tatim Taksash*”).
2. Bashkia Konispol, njësia përgjegjëse me Urdhërin 12, datë 23.01.2020 ka hartuar planin vjetor të rekrutimit në përputhje me vendimin nr. 108, datë 26.02.2014, të Këshillit të Ministrave, “*Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil*” dhe ka shpallur pozicionet vakante për t’u plotësuar me anë të procedurave të konkurrencës.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 “*Kodi i procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*” dhe Rregulloren, “*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*”, miratuar me Vendimin Nr.17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të Vendimit Nr. 116, datë 05.11.2019, të Komisionerit, *“Mbi përfundimin e verifikimit të kryer në institucionin e qeverisjes vendore Bashkia Konispol, të filluar me urdhrin nr. 65, datë 12.9.2019, të Komisionerit, në lidhje me evidentimin e rasteve të emërimeve në kundërshtim me ligjin në pozicione pune që janë pjesë e shërbimit civil, si dhe zbatimin e standardeve ligjore në strukturimin e shërbimit civil, në përputhje me parimet e ligjit për nëpunësin civil, në këtë bashki”*.
2. Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e institucionit Bashkia Konispol.
3. Për këtë vendim të njoftohet institucioni Bashkia Konispol.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha